

# AGENDA

<b>EMRI I NGJARJES VENDI</b>	<b>Si ndërveprojnë migrimi, kapitali njerëzor dhe tregu i punës në Kosovë</b> <b>Webinar në internet, i organizuar në Zoom</b>
<b>Data:</b>	<b>27 maj 2021, ora 10:00 - 12:30</b>
<b>REGJISTRIMI</b>	<b>Linku në Zoom</b>



## KONCEPTI

Vendet e Ballkanit Perëndimor karakterizohen nga popullsia në rënie e shtyrë nga niveli i ulët i lindjeve, plakja e popullsisë dhe emigrimi i vazhdueshëm. Emigrimi nga rajoni ka qenë konstant që nga vitet 1990, duke evoluar nga migracioni i parregullt i fuqisë punëtore me shkathtësi të ulëta e të mesme deri te ribashkimi i rregullt familjar, studentë ndërkombëtarë dhe, së fundmi, migrim i fuqisë punëtore më shkathtësi të larta.

Në vitin 2020, Fondacioni Evropian për Trajnime (ETF), së bashku me Institutin e Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare (wiiw), iniciuan një studim rajonal të titulluar “Dinamikat e migrimit nga perspektiva e kapitalit njerëzor në Ballkanin Perëndimor”. Qëllimi i studimit ishte të hidhej dritë mbi marrëdhëniet trekëndëshe midis formimit të kapitalit njerëzor, tregjeve të punës dhe migrimit, dhe të përcaktojë si ndikon funksionimi aktual i sistemit arsimor dhe tregut të punës në migrimin në secilin vend.

Si rezultat i studimit, u hartua raporti për vendin “Si ndërveprojnë migrimi, kapitali njerëzor dhe tregu i punës në Kosovë” bazuar në një kornizë të përbashkët analitike të zhvilluar nga ETF dhe wiiw.

**Objektivi i webinarit** është të prezantohen dhe diskutohen gjetjet kryesore të studimit të vendit në një grup të vogël pjesëmarrësish nga institucionet përkatëse publike, hulumtuesit, shoqëria civile dhe donatorët në Kosovë. Temat e diskutimit do të përfshijnë përbërjen arsimore/të aftësive të emigrantëve kosovarë, arsyet dhe llojet e flukseve të fundit migratore, ndikimin e tregut të punës dhe strukturat arsimore mbi migracionin dhe politikat kryesore për të përmirësuar marrëdhënien trekëndëshe midis migrimit, arsimit dhe tregjeve të punës.

**Rezultati i webinarit** është kontrollimi dhe vërtetimi i gjetjeve kryesore të studimit për Kosovën. Informatat kthyesë të pranuar nga pjesëmarrësit do të merren parasysh në finalizimin e raportit për vendin, i cili do të shpërndahet gjerësisht.

**Detajet e organizimit:** Kjo punëtori online do të mbahet në anglisht, me interpretim simultan në gjuhën shqipe. Pjesëmarrëseve të regjistruar do t’iu dërgohet në email një *link për tu kyçur në webinar në zoom*. Ju lutemi të lidheni në orën 9:45 në mënyrë që të testohen cilësimet dhe lidhja e audios dhe videos.

**Webinar: Si ndërveprojnë migrimi, kapitali njerëzor dhe tregu i punës në Kosovë**  
**27 maj 2021 (e enjte), 10:00 - 12:30**

**DRAFT AGJENDA**

**Kryesuesi: Evelyn Viertel, Fondacioni Evropian për Trajnime (ETF)**

09:45 – 10:00	Organizatori hap webinarin dhe mundëson të testohet pjesa teknike (p.sh. video, zëri)
10:00 – 10:15	<b>Mirëseardhja dhe hyrja</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• <b>Znj. Manuela Prina</b>, ETF, Shefe e Njesisë për identifikimin dhe zhvillimin e shkathtësive</li><li>• <b>Z.Ylber Aliu</b>, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Departamenti për Punë</li></ul>
10:15 – 10:25	• <b>Prezantimi i kornizës analitike për analizimin e migracionit, kapitalit njerëzor dhe tregjeve të punës</b> , Michael Landesmann, wiiw, Koordinator i Projektit
10:25 – 11:15	• <b>Prezantimi i gjetjeve kryesore të studimit për vendin mbi migracionin, kapitalin njerëzor dhe tregun e punës në Kosovë</b> , Prof. Asoc. Ardiana Gashi, Universiteti i Prishtinës  Pyetje dhe diskutim
11:15 – 11:25	Pauzë për kafe
11:25 – 12:25	<b>Moderator: Ummuhan Bardak</b> , ETF, Specialist i tregut të punës dhe migracionit <b>Diskutim në panel mbi gjetjet kryesore dhe implikimet e politikave</b> (10 minuta për komente nga aktorët kryesorë) <ul style="list-style-type: none"><li>▪ <b>Znj. Nora Latifi Jashari</b>, Drejtoreshë Ekzekutive e Institutit GAP për studime të avancuara</li><li>▪ <b>Dr. Will Bartlett</b>, Studiues i lartë vizitues, LSEE (Kërkim mbi Evropën Jug-Lindore)</li></ul> Pyetje dhe diskutim
12:25 – 12:30	<b>Konkluzione dhe hapat e ardhshëm</b> , Ummuhan Bardak, ETF